



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:069579

Datë: 24.04.2019

Numri i dokumentit: 00290008

P.nr.2036/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.G nga fshati ... Komuna e ..., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.518-6/18 të datës 18.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të shtetit Besim Susuri dhe të akuzuarit, më datë 12.04.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

A. G, nga i ati A. dhe e ëma F., e vajzërisë B., i lindur më dt.... në tani jeton në fshatin Komuna e, me profesion bari, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se më datë 17.02.2018, rreth orës 21:00, në fshatin, Komuna e, saktësisht në stallën e bagëtime, e cila gjendet në një kodrinë të fshatit, i akuzuari mban në pronësi, kontroll ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të së njëjtës stallë nga ana e policisë, i është gjetur një pushkë gjysmë automatike e modelit “...”, me nr.serik, një, dhe një pushkë gjuetie me mbishkrimin “...”, me nr.serik, të cilat i ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim, në kundërshtim me ligjin nr.05/L-022 për armët.

Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit të lartëshënuar dhe neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 46, 73 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **1.200 (një mijë e dyqindë euro)**, të cilën shumë i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë i njëjti do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro i llogaritet një ditë burgim, respektivisht gjashtëdhjetë (60) ditë burgim.

Konform nenit 374 par.3 të KP-së, të akuzuarit i konfiskohen: një pushkë gjysëm automatike e modelit me nr.serik, një karikator dhe një pushkë gjuetie me mbishkrimin “...”, me nr.serik si objekte të kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore-Departamenti i Përgjithshëm- Prokurori i Shtetit, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.518-6/18 të datës 18.12.2018, kundër të akuzuarit A.G nga fshati Komuna e, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilën i akuzuari A.G nga fshati Komuna e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vertetua, se i akuzuari A. G., ditën kritike se më më datë 17.02.2018, rreth orës 21:00, në fshatin, Komuna e, saktësisht në stallën e tij të bagëtive e cila gjendet në një kodrinë të fshatit, mban në pronësi, kontroll ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armën të tilla, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të së njëjtës stallë nga ana e policisë, i është gjetur një pushkë gjysmë automatike e modelit “...”, me nr.serik, një karikator dhe një pushkë gjuetie me mbishkrimin “...”, me nr.serik të cilat i ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim, në kundërshtim me ligjin nr..... për armët.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari A. G, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimit i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim kan qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, shprehja e pendimit të thellë dhe premtimin para gjykatës se në të ardhmen nuk do të ndërmerr veprime të tilla, si dhe gjendjen e tij ekonomike. Kështu që kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe sipas bindjes së gjykatës dënimin i tillë do të ndikoj mjaftueshëm te i akuzuari dhe në rrethanën ku ai jeton që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla inkriminuese.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në kuptim të nenit 374 par.3 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të ligjit nr.05/L-036.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2018:069579, 12.04.2019

Procesmbajtësja
Luljeta Luboteni

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.